

AKT THEMELIMI
|
SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR
“ **MEA Technology” SHPK**

Ortaku i vetem i Shoqërisë Enea Arapaj , me atësi Edmond dhe amësi Valbona , dtl 07/04/1997, lindur ne Tirane dhe banues në Tiranë rruga “ Njazi Meka”, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar,bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”. Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007. “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar. Mbledhur në Tiranë sot më datë 13/04/2021

i mbledhur në Tiranë sot më datë 13/04/2021

VENDOSI:

Të krijojë një shoqëri tregtare dhe për këtë qëllim të hartojë dhe miratojë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon.

NENI 1

Emri

Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin tregtar me emërtimin e saj **“MEA Technology” sh.p.k.**

Ndryshimi i emrit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqerise (Ortaku i vetem).

NENI 2

Forma juridike

Shoqëria tregtare **“MEA Technology” shpk**, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k).

Shoqëria mund të transformohet në një formë tjeter juridike me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Ortaku i Vetem) sipas përcaktimeve në ligj dhe në Statutin e saj.



NENI 3

Selia

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Rruga "Abdyl Frasherri", Hyrja 1, Apartamenti 16, Hekla Center Tirane

Ndryshimi i selise se shoqerise mund te behet vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise (Ortaku i Vetem).

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë (Ortaku i Vetëm) shoqëria mund të hapë degë të saj apo Zyra përfaqësimi në qytete të tjera apo dhe jashtë Shqipërisë.

NENI 4

Vula e Shoqerise

Shoqëria do të ketë vulën e saj.

Forma e vulës dhe masa e saj do të përcaktohen nga Asambleja e Ortakëve (Ortaku i vetëm) në përputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 5

Objekti i Veprimitarise

Shoqëria ka si objekt veprimitaritë që vijojnë më poshtë:

Konsulencë tregtare dhe organizative në të gjitha format dhe në të gjithe sektorët e aktiviteteve brenda dhe jashtë vendit; projektim dhe realizim të programeve formuese dhe te zhvillimit të burimeve njerëzore; promovimi i aktivitetëve me karakter publicitar; projektimi dhe realizimi i fushatave publicitare dhe promovuese nëpërmjet shfrytëzimit të të gjitha instrumentave, përfshire marketingun telefonik dhe instrumentave të tjera të marketingut të drejtperdrejte; sherbime marketingu brenda dhe jashtë territorit te Republikës se Shqiperise nepermjet telefonit dhe internetit; projektimi dhe realizimi i fushatave publicitare dhe promovuese nepermjet shfrytëzimit te të gjitha instrumentave, perfshire marketingun telefonik dhe instrumenta te tjera te marketingut nepermjet internetit;

Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çfarëdolloj veprimitarie tjetër të lejuar nga ligji dhe në përputhje me rregullat në fuqi.

NENI 6

Kohezgjatja e shoqerise

6.1 Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje me një afat të pacaktuar.

6.2 Shoqëria ka përsoshatjet juridik duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 7

Kapitali i shoqerise dhe kuotat

Kapitali i regjistruar i shoqerise eshte i perbere nga kontributi ne para i Ortakut te vetem ne vleren 10.000 leke.

Ortaku i Vetem i Shoqerise, zoteron nje kuote me vleren 10.000 leke (dhjete mije leke), e cila perben 100% te kapitalit te regjistruar te shoqerise.

Kontributet që perbejne 100% të kapitalit te regjistruar të shoqërisë janë shlyer tërësisht nga Ortaku i Vëtem.

Financimet në formë huaje të bëra nga ortaku do të konsiderohen si hua pa interes.

NENI 8

Organet e Shoqerise

Organet e drejtimit të shoqerise janë: Ansambleja e Përgjithshme (Ortaku i vetem).

Administratori

Kompetencat, të drejtat dhe detyrat e këtyre organeve do të përcaktohen në statutin e shoqerise

NENI 9

Te drejtat dhe detyrimet e ortakut te vetem

9.1 Ortaku jep kontributin e tij në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut në të cilën është përcaktuar në mënyrë të detajuar kontributi dhe mënyra e afatet e derdhjes se këtij kontributi në këte shoqëri. Ortaku i Vetëm përgjigjet ndaj shoqërisë personalisht dhe në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga mospërmbushja e këtyre detyrimeve apo nga përbushja e tyre përtëj afateve përkatëse. Ortaku i Vetem mban përgjegjësi për humbjet e shoqerisë deri në pjesën e pashlyer te kontributeve të nënshkruara.

9.2 Personat përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë ortakun për ecurinë e veprimtarisë, së shoqërisë tregtare dhe me kérkesën e tij, duhet t'i vëne në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë.

9.3 Personat përgjegjes për administrimin e shoqerise informojnë Ortakun e Vetem per periudha njemjore dhe tremujore per ecurine e shoqerise, realizimin e objektivave mujore dhe tremujore. Llogarite, raportet per gjendjen dhe ecurine e veprimitarise se shoqerise tregtare me partneret nenkontraktore, raportet e organeve drejtuese apo të eksperteve kontabël te autorizuar, si dhe çdo dokument tjeter te brendshem te shoqerise.

9.4 Ortaku i Vetëm i Shoqërisë ka të drejtë të heqi dorë nga Shoqëria dhe mund të shesi kuotën nëpërmjet nenshkrimit të kontrates së shitjes se kuotës, pa qenë nevoja e marrjes së një vendimi paraprak nga ortaku i Vetëm i Shoqërisë në përputhje me kushtet që i lejon Statuti dhe Ligji Hegja dorë nga shoqëria nuk e liron atë nga detyrimet qe ka deri në momentin e heqjes dorë dhe nuk e cënon atë ne marrjen e të ardhurave që Shoqëria ka siguruar deri në këtë moment.

9.5 Gjatë ushtrimit të të drejtave, Ortaku i Vetëm vepron duke marrë parasysh interesat e shoqërisë. Ortaku i Vetëm respekton detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ai përpitet për zhvillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit të veprimtarisë së saj.

NENI 10 **Administratori**

Shoqeria administrohet nga një administrator qe emerohet dhe shkarkohet nga Ansambleja e Përgjithshme (Ortaku i vetem). Afati i emerimit eshte 5 vjet me te drejte riperseritje

Administrator i Shoqerise eshte Z. Enea Arapaj , me atesi Edmond dhe amesi Vabona , dtl. 07/04/1997 lindur Tirane, dhe banues ne Tirane. Rr. " Njazi Meka " madhor me zotesi te plotë juridike dhe per te vepruar, identifikuar me nr ID. 032682982 dhe nr. Personal J70407045Q .

10.3. Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i vetëm) mund të emërojë një administrator të dytë me vendim të saj.

NENI 11.

11.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj, në përputhje të plotë me Aktin e Themelimit, Statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi. Për sa nuk parashikohet në Aktin e Themelimit dhe në Status do të zbatohen kryesisht dispozitat e ligjit «Për tregtarët dhe shoqeritë tregtare» Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi.

NENI 12

12.1 Ky Akt themelimi perpilohet ne 5 (pese) kopje identike ne gjuhen shqipe dhe u nenshkrua pa verejtje nga ortaku themelues.

ORTAKU THEMELUES

Enea Arapi

